



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

## Njoftim publik

Në Drejtorinë e Urbanizmit – Komuna e Prishtinës, është dorëzuar kërkesa nr. 05-015/2-133203/19, dt. 10.06.2019, e Abdullah QAHILIT, pronar i një lokali afarist, përmes së cilës kërkohet të “identifikohet adresa e lokalit i cili gjendet në lagjen Dardani.

Agjencia Kadastrale e Kosovës ka digjitalizuar (si rrugë të re) segmentin e rrugës që shtrihet në këtë hapësirë, ndërsa Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës duke u bazuar në Neni 2, 7 dhe 8 të Ligjit Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave, Vendimin 01 nr. 031 -223419 të Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe Neni 6, pika 1.2., pika 1.2.1.2., pika 1.2.2. dhe pika 1.2.3., Neni 7, pika 1, pika 2, pika 2.1., 2.2. 2.3. dhe pika 2.4., të Udhëzimit Administrativ Nr. 14/2012 të MMPH – së, i ka dhënë kësaj rruge të re një kod të veçantë (kodi 10766) dhe ka bërë propozimin për emërtim të kësaj rruge.

Emri i propozuar: **“RAMIZ ABDYLI”** (1928-1996) – Akademik, profesor, ushtarak me gradën e gjeneralit

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 26.06.2019 deri më 09.07.2019, në E-mail adresën: [urbanizmi@prishtine@rks-gov.net](mailto:urbanizmi@prishtine@rks-gov.net)

Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 14/201 të MMPH –së, për krijimin dhe administrimin e listës alfabetike për emërtime, listës rezervë dhe vendosjen e tyre nga regjistri komunal, neni 7, paragrafët 1 dhe 2, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në web-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në web-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet tuaja duhet të përshkruhet numri i kërkesës të shënuar më lartë.



Nënshkrimi i Zyrtarit:

